



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:228393
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05571104

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0018-A0001

Paditëse

F J A ,Suedi.

Kundër:

E paditura/Ankuesja

N.SH. “Energomontimi” (në likuidim), Prishtinë, me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1269, të datës 22 dhjetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 prill 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-1269, i datës 22 dhjetor 2022.
3. Vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI103-0082 i datës 8 qershor 2015.
4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 6 korrik 2015, paditësja kishte paraqitur një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI103-0082 të datës 8 qershor 2015, me të cilin vendim kërkesa e paditëses për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 900.00 euro ishte refuzuar si e pavlefshme. Kjo për faktin se në bazë të arkivës së N.SH-së kishte rezultuar se parashtruesi i kërkesës nuk ishte një punonjës aktiv i N.SH-së dhe sipas listës së pagave dhe evidencave të ndërmarrjes parashtruesja nuk ka ofruar shërbime për ndërmarrjen që nga qershori i vitit 2012. Andaj Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se parashtruesja e kërkesës nuk ka qenë punëtore aktive.

Në ankesë paditësja kishte theksuar se të njëjtës i takon dëmshpërblimi i kërkuar me anë të kërkesës së paraqitur në Autoritetin e Likuidimit, se e njëjta ka qenë punëtore e rregullt në ndërmarrjen N.SH D.T.P. “Mladost” Shtërpce dhe ky dëmshpërblim mendon se është i merituar. Ankesës i kishte bashkëngjitur: vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI103-0082 të datës 8 qershor 2015.

Me datë 10 nëntor 2022, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesja në rastin konkret nuk kishte treguar se cili nen i ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit gjatë marrjes së vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të Ligjit për DHPGJS-në i cili parashikon se ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me ligjin për AKP-në. Duke u bazuar në arkivin e N.SH-së procedura e likuidimit të ndërmarrjes në fjalë kishte filluar me datë 16 qershor 2014. Pas shqyrtimit të arkivës së ndërmarrjes në fjalë, Autoriteti i Likuidimit kishte konstatuar se parashtruesja nuk ishte një punonjëse aktive e N.SH-së. Sipas listës së pagave dhe evidencave të ndërmarrjes, parashtruesja e kërkesës nuk ka qenë punëtore aktive e N.SH-së dhe nuk është pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet ankesa e parashtrueses si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI103-0082 të datës 8 qershor 2015.

Me datë 22 dhjetor 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1269 kishte miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke ndryshuar kështu vendimin e Autoritetit të

Likuidimit, ashtu që kishte detyruar të paditurën, AKP-në që paditëses në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t'ia paguaj shumën prej 900.00 euro sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se gjykata kishte ardhur në përfundim se kërkesa për dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së kontratës së punës ishte e bazua. Sipas pohimeve të AKP-së paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në ndërmarrje por nuk kishte kryer shërbime dhe nuk ka marrë paga pas qershor 2012. Ndërmarrja kishte shkuar në procedurë likuidimit në qershor të vitit 2014. Gjykata kishte potencuar se edhe nëse paditësja nuk ka kryer shërbime në periudhën 2012-2014 ajo ka qenë punëtore e ndërmarrjes. Në atë kohë ndërmarrja ka qenë nën administrimin ligjor të AKP-së që të menaxhoj me punëtorët e ndërmarrjes. Sigurisht se nuk ka qenë faji i paditëses që nuk ka qenë aktive në dy vitet e fundit para likuidimit të ndërmarrjes, përndryshe ndërmarrja apo AKP-ja do të ndërmernte masa adekuate ndaj saj.

Andaj nga kjo gjykata kishte konstatuar se rrjedh konkludimi se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në ndërmarrje deri në ditën që ndërmarrja ka hyrë në procedurë të likuidimit. Në fund gjykata kishte konstatuar se e paditura nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë lidhur me lartësinë e saj, as me vendimin e lëshuar nga AL dhe përgjigjen në padi. Andaj nga këto arsye që u paraqiten më lartë, gjykata e kishte miratuar kërkesëpadinë e paditëses edhe në aspektin e lartësisë së detyrimit për dëmshpërblim.

Me datë 16 janar 2023, e paditura kishte paraqitur një ankesë ndaj Aktgjykimit C-IV-15-1269 të datës 22 dhjetor 2022, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar duke refuzuar ankesën e paditësit ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit dhe duke vërtetuar këtë të fundit. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Tutje, ankuesja konstaton se parashtruesja e kërkesës nuk ishte punonjëse aktive e N.SH-së pasi që sipas listës së pagave dhe evidencës së ndërmarrjes e njëjta nuk ka ofruar shërbime për ndërmarrjen që nga qershor i vitit 2012. Autoriteti i Likuidimit

fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar, vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 7 prill 2023, Kolegji i Apelit kishte lëshuar një urdhër për paditësen me qëllim të përcjelljes së ankesës së palës së paditur, për përgjigje në ankesë, Mirëpo pas dështimit të dorëzimit-pranimit të dokumentit në adresën e dhënë nga paditësja dhe atë "*Hallsberg 69432, Sverige, Suedi*", ky urdhër është publikuar në Tabelën e Shpalljeve i cili ka qëndruar në këtë tabelë nga data 13 prill 2023 deri më 20 prill 2023.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj i njëjti duhet të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 900.00 euro ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak se në bazë të listave të pagave dhe evidencave të ndërmarrjes, Autoriteti i Likuidimit kishte konsideruar se paditësja nuk ka qenë punonjëse aktive e N.SH-së që nga qershori i vitit 2012 dhe se të njëjtës nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së.

Paditësja me rastin e ankimimit të vendimit të lartcekur si provë kishte bashkëngjitur vetëm vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe kishte theksuar se ka qenë punëtore e rregullt në ndërmarrjen në fjalë, prandaj kishte konsideruar se i takon ky dëmshpërblim.

Shkalla e parë e DHPGJS, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditëses të drejtën në kompensim në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 900.00 euro.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS nuk kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e bazuar.

Kjo për faktin se paditësja me rastin e paraqitjes së ankesës përveç deklarimit të saj në ankesë se “Unë kam qenë punëtore e rregullt në ndërmarrjen N.SH D.P.T “Mladost” Shtërpce dhe ky dëmshpërblim mendoj se është i merituar”, në asnjë formë nuk e argumenton pretendimin e saj për dëmshpërblimin e kërkuar duke mos bashkëngjitur kështu asnjë provë të vetme në mbështetje të pretendimeve të saj, siç mund të ishte njoftimi nga ana e AKP-së për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës apo kopjen e librezës së punës.

Tutje, Kolegji i Apelit vlerëson se e njëjta me asnjë provë nuk kishte dëshmuar se e kishte paraqitur kërkesën e saj në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtrueses që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit dhe kështu të ndërprente afatin e parashkrimit.

Barra e provës për të vërtetuar këto pretendime bie mbi paditësen. Paditësja përveç vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit që ndodhet në shkresa të lëndës, nuk kishte vërtetuar me asnjë provë faktin se me anë të vendimit/veprimit të AKP-së i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe kështu të ndërprente afatin e parashkrimit.

Prandaj, Kolegji i Apelit vlerëson se Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së duhet të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pabazuar në mungesë të provave.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 23 janar 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 12 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____